



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6182 prot

Roskovec, më 17.07 2025

VENDIM

Nr. 38, datë 16.07 2025

PËR

**MIRATIMIN E STRATEGJISË LOKALE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË
BASHKINË ROSKOVEC 2025-2030**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", shkronja k "Miraton norma, standarte e kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik", Ligji Nr. 93/2015 "Për Turizmin" i ndryshuar me Ligjin Nr.114/2017, datë 18.12.2017; Nr.101/2018 datë 13.12.2018; Nr.30/2024 datë 04.04.2024. Bashkia Roskovec ka hartuar "Strategjinë Lokale për Zhvillimin e Turizmit 2025-2030" e cila është në përputhje të drejtpërdrejtë me Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2024-2030; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :


1. Miratimin e "Strategjisë Lokale për Zhvillimin e Turizmit në Bashkinë Roskovec 2025-2030" sipas materjalit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturore, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.





STRATEGJIA LOKALE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË BASHKINË ROSKOVEC 2025–2030

BASHKIA ROSKOVEC



Shënim mbi dokumentin - Ky dokument është pronësi intelektuale e Bashkisë Roskovec. Përdorimi i përmbajtjes dhe të dhënave të përfshira në këtë strategji lejohet vetëm me citimin përkatës të burimit dhe referencave zyrtare.

PERMBAJTJA

1	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
2	HYRJE.....	7
2.1	Qëllimi i Strategjisë.....	7
2.2	Objektivat Kryesore të Strategjisë	7
2.3	Metodologjia e Hartimit të Strategjisë	8
2.4	Përputhshmëria me Strategjitë Kombëtare dhe Dokumentet e Planifikimit Vendor.....	10
3	ANALIZA E SITUATËS AKTUALE.....	12
3.1	Hyrje: Profili i Bashkisë Roskovec	12
3.2	Burimet Turistike	13
3.2.1	Trashëgimia Kulturore dhe Historike.....	13
3.2.2	Trashëgimia Natyrore dhe Ekologjike e Roskovecit.....	14
3.3	Infrastruktura dhe Aksesueshmëria	15
3.3.1	Pozita Gjeografike dhe Aksesueshmëria Rajonale.....	15
3.3.2	Infrastruktura Rrugore dhe Sinjalistika	16
3.3.3	Akomodimi në Territorin e Bashkisë.....	17
3.3.4	Shërbimet Mbështetëse Turistike	18
3.4	Oferta Turistike Aktuale	19
3.4.1	Agroturizmi	20
3.4.2	Ekoturizmi.....	20
3.4.3	Turizmi Kulturor	21
3.4.4	Eventet Lokale dhe Festivalet	21
3.5	Analiza SWOT	22
3.5.1	Forcat (Strengths).....	23
3.5.2	Dobësitë (Eëaknesses).....	23
3.5.3	Mundësitë (Opportunities)	24
3.5.4	Kërcënimet (Threats).....	25
4	VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE.....	26
4.1	Vizioni	26

LISTA E AKRONIMEVE

AKT	Agjencia Kombëtare e Turizmit
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi European
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
INLSH	Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri
IPA	Instrumenti i Para-Aderimit
IPA III	Instrumenti i Para-Aderimit i Bashkimit Evropian – Faza e Tretë
MF	Ministria e Financave
MoE	Ministria e Ekonomisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
OJF	Organizata Jo-Fitimprurëse
ReLOaD2	Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor – Faza II
RSH	Republika e Shqipërisë
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (United Nations Development Programme)
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Strategjia është ndërtuar si dokument dinamik dhe fleksibël, që mund të përshtatet ndaj ndryshimeve në tregun turistik, zhvillimeve mjedisore dhe nevojave të komunitetit, duke synuar që deri në vitin 2030 turizmi të përfaqësojë një shtyllë të konsoliduar të zhvillimit vendor për Bashkinë Roskovec.

2 HYRJE

2.1 Qëllimi i Strategjisë

Strategjia Lokale për Zhvillimin e Turizmit në Bashkinë Roskovec (2025–2030) ka për qëllim të vendosë një kuadër orientues për zhvillimin e një turizmi të **qëndrueshëm, të integruar dhe të aksesueshëm**, duke u bazuar në burimet natyrore, kulturore dhe sociale të territorit. Strategjia synon të jetë një **udhërrëfyes praktik** për Bashkinë Roskovec dhe aktorët lokalë, duke mbështetur një qasje të thjeshtë dhe të zbatueshme për zhvillimin turistik vendor.

Duke qenë se kjo është strategjia e parë e turizmit për Bashkinë Roskovec, dokumenti është ndërtuar mbi parimin e:


- **Përfshirjes së komunitetit lokal** në të gjitha fazat e zhvillimit turistik;
- **Mbështetjes së sipërmarrjes lokale**, sidomos në sektorët e agroturizmit, artizanatit dhe turizmit kulturor;
- **Përdorimit të burimeve ekzistuese** në mënyrë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme.

Strategjia përqendrohet në:

- Evidentimin dhe promovimin e potencialeve natyrore dhe kulturore të Roskovecit;
- Zhvillimin e një oferte turistike autentike dhe të diversifikuar;
- Përmirësimin e infrastrukturës bazë dhe shërbimeve për vizitorët;
- Nxitjen e bashkëpunimit publik-privat dhe forcimin e identitetit turistik të bashkisë.

2.2 Objektivat Kryesore të Strategjisë

Strategjia synon të mbështesë zhvillimin e turizmit vendor përmes këtyre objektivave kryesore:



Një rol të veçantë në koordinimin dhe orientimin e gjithë procesit ka luajtur Grupi i Punës i ngritur pranë Bashkisë Roskovec, i cili ka qenë përgjegjës për mbledhjen e informacionit bazë, verifikimin e përputhshmërisë së masave me prioritetet e zhvillimit vendor, si dhe për harmonizimin e të gjithë inputeve të marra nga aktorët e përfshirë. Gjithashtu, bashkëpunimi me ekspertë të fushës dhe me institucione mbështetëse ka ndihmuar në pasurimin e analizave dhe në ndërtimin e alternativave të mundshme për zhvillimin e sektorit.

Gjatë hartimit të këtij dokumenti janë aplikuar disa metoda të kombinuara të punës, të cilat kanë garantuar si thellësinë analitike ashtu edhe përfshirjen e aktorëve lokalë. Në radhë të parë është kryer një rishikim i plotë i dokumenteve të planifikimit ekzistues, si në nivel vendor ashtu edhe kombëtar, për të siguruar përputhshmërinë e strategjisë me politikat dhe prioritetet zhvillimore të qeverisjes vendore dhe qendrore në fushën e turizmit, zhvillimit ekonomik dhe trashëgimisë kulturore. Paralelisht, është realizuar një analizë e thelluar e potencialeve turistike të Bashkisë Roskovec, ku janë identifikuar dhe dokumentuar resurset natyrore, kulturore, historike dhe sociale të territorit, të cilat përbëjnë bazën për ndërtimin e produkteve të ardhshme turistike.

Në vijim, është përdorur edhe analiza SËOT, e cila ka ndihmuar në identifikimin dhe vlerësimin e pikave të forta dhe të dobëta të sektorit, si dhe në analizimin e mundësive dhe kërcënimeve që mund të ndikojnë në perspektivën e zhvillimit të turizmit në bashki. Përmes kësaj analize, janë identifikuar prioritetet strategjike të ndërhyrjes dhe janë përcaktuar fushat ku duhet të fokusohet mbështetja institucionale.

Procesi ka përfshirë edhe një komponent të rëndësishëm të vlerësimit të praktikave të mira dhe modeleve të suksesshme, të zbatuara në bashki të tjera vendore brenda vendit ose në rajone të ngjashme, me qëllim për të përshtatur zgjidhje praktike dhe të realizueshme që mund të aplikohen në kontekstin e Roskovecit. Gjithashtu, janë kryer vëzhgime në terren dhe janë përdorur harta tematike për dokumentimin vizual të resurseve turistike, infrastrukturës dhe shërbimeve mbështetëse, duke mundësuar një kuptim më të detajuar të nevojave për ndërhyrje konkrete.

Më poshtë, është paraqitur një diagram përmbledhës që paraqet vizualisht hapat kryesorë të ndjekur gjatë hartimit të strategjisë, duke ilustruar fazat analitike dhe konsultative, si dhe rolin e aktorëve të përfshirë në të gjitha etapat e procesit.

Qasja metodologjike e ndjekur në këtë proces ka siguruar që strategjia të jetë e ndërtuar mbi evidenca faktike dhe të reflektojë realisht prioritetet, sfidat dhe aspiratat e komunitetit të Roskovecit, duke e bërë atë një dokument të realizueshëm në praktikë dhe të përshtatshëm për kapacitetet aktuale institucionale dhe financiare të bashkisë.

zhvillimore, duke i kthyer ato në masa të strukturuar të veprimit që synojnë forcimin e rolit të turizmit si një nga sektorët potencialë për gjenerimin e zhvillimit ekonomik lokal dhe përmirësimin e mirëqenies së komunitetit.

Gjithashtu, strategjia lokale është ndërtuar në përputhje me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale të hartuara nga institucionet qendrore përgjegjëse, si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës dhe institucionet e tjera me rol në zhvillimin rural dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, duke reflektuar objektivat për ruajtjen dhe valorizimin e aseteve natyrore dhe kulturore të territorit. Po ashtu, është marrë parasysh edhe dimensionin rajonal i zhvillimit, përmes integrimit të linjave prioritare të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit Rajonal të Qarkut Fier, në mënyrë që ndërhyrjet e planifikuara të jenë të harmonizuara me zhvillimet rajonale dhe të kontribuojnë në krijimin e sinergjive ndërbashkiake.

Ky harmonizim vertikal dhe horizontal midis strategjisë lokale dhe dokumenteve strategjike kombëtare, sektoriale, rajonale dhe vendore garanton që dokumenti të mos funksionojë thjesht si një udhërrëfyes lokal i kufizuar, por si pjesë integrale e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në Shqipëri, në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe prioritetet e procesit të integrimit evropian të vendit.



3.2 Burimet Turistike

3.2.1 Trashëgimia Kulturore dhe Historike

Territori i Bashkisë Roskovec përmban një trashëgimi të pasur kulturore dhe historike, e cila përbën një aset me rëndësi të veçantë për zhvillimin e turizmit kulturor, edukativ dhe të qëndrueshëm. Ky fond i pasur kulturor është i shpërndarë në forma të ndryshme monumentesh, sitesh historike, ndërtesash me vlera arkitektonike, praktikash tradicionale dhe elementësh të trashëgimisë gojore si pjesë e trashëgimisë kulturore jomateriale të komunitetit, të cilat së bashku i japin identitetin karakteristik zonës.

Një nga elementët më të spikatur të trashëgimisë së Roskovecit është **Pazari i Vjetër i Roskovecit**, i njohur ndryshe edhe si Pazar i Frashërit. I pozicionuar historikisht si nyje e rëndësishme tregtare, pazari ka qenë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe shkëmbimeve mes Beratit dhe zonave bregdetare përmes itinerareve historike që kalonin pikërisht në këtë zonë. Ky pozicion strategjik i ka mundësuar Roskovecit të luajë një rol aktiv ekonomik, duke nxitur zhvillimin e këtij pazari si qendër e rëndësishme tregtare në periudhat e mëparshme. Sot, Pazar i Vjetër përfaqëson një dëshmi autentike të zhvillimit urban, ekonomik dhe kulturor të zonës dhe përbën një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e produkteve të turizmit kulturor dhe edukativ.

Brenda qendrës urbane të Roskovecit evidentohet gjithashtu ndërtimi i parë me funksione të kombinuara tregtare dhe hoteliere, i ngritur në vitin 1932 nga Ali Ibrahim Çepelja. Kjo ndërtesë, për kohën e vet, përfaqësonte një shembull të avancuar të organizimit funksional dhe arkitekturor, duke ofruar standarde të larta të mikpritjes dhe duke dëshmuar për praninë e hershme të shërbimeve të organizuara të akomodimit dhe tregtisë në këtë territor. Ndërtesa, edhe sot, ruan vlera të rëndësishme si pjesë e trashëgimisë arkitektonike dhe historike të qytetit.

Trashëgimia kulturore e Roskovecit pasurohet më tej edhe me **monumente fetare** që mbartin vlera të larta historike, shpirtërore dhe artistike. Ndër to spikat **Kisha e Shën Gjergjit**, e vendosur pranë fshatit Strum, e cila përveç rëndësisë së saj kulturore, përfiton edhe nga pozicioni natyror që e rrethon, duke e bërë një pikë tërheqëse për vizitorët që kërkojnë përvoja të kombinuara natyrore dhe shpirtërore. Kjo kishë kërkon ndërhyrje restauruese për të mbrojtur dhe valorizuar më tej vlerat e saj arkitektonike dhe historike.

Një tjetër monument me rëndësi të veçantë është **Kisha e Shën Kollit në fshatin Kurjan**, e ndërtuar në shekullin XIII. Kjo kishë ruan një fond të pasur afreskesh të piktorëve të njohur të periudhës, përfshirë Nikolla, birin e mjeshtrit të famshëm Onufri, dhe Johan. Pozicioni i kishës mbi kodër ofron gjithashtu një pamje panoramike mbresëlënëse mbi fushën përreth, duke e kthyer atë në një pikë tërheqëse për turistët kulturorë dhe pelegrinët.

Identiteti kulturor i Roskovecit është i ndërthurur ngushtë edhe me **trashëgiminë gojore si pjesë e trashëgimisë kulturore jomateriale të komunitetit**, të pasqyruar në legjenda dhe tregime që përforcojnë lidhjen midis komunitetit dhe peizazhit natyror. **Legjenda si ajo e Liqenit të Kurjanit apo Gojëdhëna e Kënetës së Zezë** pasqyrojnë aspekte mitologjike të historisë vendase dhe ofrojnë mundësi të reja për zhvillimin e paketave të turizmit kulturor dhe edukativ, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë, duke i bërë këto rrëfime pjesë të narrativës së ofertës turistike.

fillestar të sigurimit të ujit për vaditjen e tokave bujqësore. Sot, ky liqen ka fituar edhe funksione të reja, duke u shndërruar në një hapësirë me potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e aktiviteteve rekreative dhe turistike. Përveç rolit të tij ekonomik në mbështetjen e bujqësisë, ai ofron një mjedis natyror të qetë dhe tërheqës për vizitorët që kërkojnë të angazhohen në aktivitete të ndryshme, përfshirë peshkimin, lundrimin me varka, sportet ujore dhe aktivitetet e relaksit në natyrë. Zona përreth liqenit ofron kushte të favorshme për zhvillimin e ekoturizmit familjar dhe të programeve edukative në natyrë, të fokusuara në rëndësinë e mbrojtjes së ujit, biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore.

Pylli i Luarit, i pozicionuar në pjesën e fshatit Luar, përfaqëson një tjetër aset natyror me rëndësi për zhvillimin e turizmit të natyrës dhe të edukimit mjedisor. Pylli përbëhet kryesisht nga pisha të buta dhe ofron një mjedis të qetë e relaksues për aktivitetet rekreative në natyrë. Përfshirja e këtij pylli në programin kombëtar “100 fshatrat” ka sjellë edhe investime të dedikuara, të cilat synojnë kthimin e zonës në një qendër të vogël turistike të orientuar drejt relaksit, shëtitjeve në natyrë dhe aktiviteteve të edukimit të rinjve për rëndësinë e ruajtjes së pyjeve dhe mjedisit. Në vijim të këtij peizazhi natyror shtrihet **Lumi Seman**, i cili përbën një tjetër element me potencial të veçantë për zhvillimin e turizmit aktiv dhe të qëndrueshëm. Ky lumë ofron kushte të favorshme për zhvillimin e sporteve ujore si kajaku dhe varkat me pedale, ndërsa brigjet e tij të qeta mund të shfrytëzohen për aktivitete të vëzhgimit të natyrës dhe edukimit mjedisor, duke e kthyer bregun e lumit në një itinerar natyror të aksesueshëm për banorët vendas dhe vizitorët.

Pjesë e rëndësishme e peizazhit natyror të Bashkisë Roskovec është edhe **Fusha e Myzeqesë**, e cila shtrihet në pjesën perëndimore të territorit të bashkisë dhe përbën një nga zonat më të rëndësishme bujqësore të vendit. Kjo fushë, e karakterizuar nga tokat e saj pjellore, është e orientuar kryesisht drejt kultivimit të perimeve, frutave dhe kulturave të tjera bujqësore që përfaqësojnë traditën prodhuese të komunitetit lokal. Falë punës së qëndrueshme të fermerëve dhe përkushtimit të komunitetit, Myzeqeja është shndërruar në një zonë me rendiment të lartë prodhimi bujqësor, duke krijuar edhe mundësi për zhvillimin e formave të strukturuar të agroturizmit. Potenciali ekzistues ekonomik mund të diversifikohet përmes krijimit të fermave pritëse, organizimit të degustimeve të produkteve bio dhe ngritjes së tregjeve lokale të prodhimeve bujqësore, duke e kthyer këtë zonë në një atraksion për vizitorët që kërkojnë përvoja autentike në ambientet rurale.

Ky mozaik burimesh natyrore dhe ekologjike ofron bazën e nevojshme për ndërtimin e një oferte të larmishme turistike për Bashkinë Roskovec, duke i dhënë zhvillimit të turizmit një dimension të qartë të orientuar drejt natyrës, qëndrueshmërisë dhe edukimit për mjedisin.

3.3 Infrastruktura dhe Aksesueshmëria

3.3.1 Pozita Gjeografike dhe Aksesueshmëria Rajonale

Bashkia Roskovec shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë, në qarkun e Fierit, duke përfutur një pozicion strategjik ndërmjet tre qendrave të rëndësishme urbane: Fierit, Lushnjës dhe Beratit. Ky pozicionim e favorizon ndjeshëm bashkinë në aspektin e aksesueshmërisë, duke e bërë atë të

ndjeshëm në ndërveprimin më të thelluar të vizitorëve me territorin, duke shtuar vlerën edukative dhe përjetuese të vizitës.

Një tjetër aspekt thelbësor i infrastrukturës lidhet me zhvillimin e ndriçimit publik dhe përmirësimin e infrastrukturës urbane në zonat qendrore dhe hapësirat publike atraktive të qytetit. Këto ndërhyrje janë të domosdoshme për të siguruar ambiente të sigurta, estetikisht tërheqëse dhe funksionale, veçanërisht gjatë orëve të mbrëmjes apo gjatë organizimit të eventeve kulturore dhe promovuese, që synohen të jenë pjesë e ofertës turistike të qytetit.

Ndikimet pozitive të përmirësimeve infrastrukturore tashmë janë evidente edhe në nivel kombëtar. Sipas të dhënave të programeve të Bankës Botërore, koha mesatare e udhëtimit në segmente të ndryshme rrugore të rehabilituara është reduktuar me 30%, ndërsa në disa segmente ky reduktim ka arritur deri në 75%, duke lehtësuar ndjeshëm lëvizjen e njerëzve dhe qarkullimin e mallrave, dhe duke nxitur aktivitetin ekonomik lokal. Në këtë kontekst, edhe Bashkia Roskovec ka përfutur ndjeshëm nga projekte të rëndësishme infrastrukturore, siç është ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugës Roskovec–Poshnje. Ky aks ka përmirësuar ndjeshëm lidhjen me zonat përreth, veçanërisht me qytetin e Beratit, dhe pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e aksesueshmërisë turistike të Roskovecit, duke e pozicionuar atë si një ndalesë të arritshme dhe tërheqëse në itineraret ndërrajonale të turizmit kulturor dhe natyror.

3.3.3 Akomodimi në Territorin e Bashkisë

Akomodimi turistik në territorin e Bashkisë Roskovec aktualisht paraqitet i kufizuar dhe i paformalizuar, duke reflektuar fazën fillestare të zhvillimit të turizmit në këtë zonë. Sipas një vlerësimi të kryer në platformat ndërkombëtare të rezervimeve online si Airbnb dhe Booking.com, apo platforma të tjera si Instagram, rezulton se në territorin e Bashkisë Roskovec mungojnë struktura të regjistruara për akomodim, çka tregon për një ofertë shumë të kufizuar dhe me prezencë të papërfaqësuar në rrjetet formale të promovimit turistik ndërkombëtar.

Kjo situatë evidentohet veçanërisht në segmentin e qëndrimeve të organizuara, të cilat janë thelbësore për të tërhequr vizitorë që kërkojnë përvoja të plota dhe të strukturuar, si turizmi fundjavor, qëndrimet familjare apo aktivitetet e orientuara drejt agroturizmit dhe ekoturizmit.

Megjithatë, pavarësisht mungesës së regjistrimeve formale në platformat ndërkombëtare, në territorin e bashkisë veprojnë aktualisht të paktën dy struktura të vogla mikpritjeje, të cilat ofrojnë shërbime akomodimi në mënyrë të kufizuar: **bujtina “Arbër” në fshatin Kurjan**, e pozicionuar pranë liqenit dhe kishës së Shën Kollit, që ofron ambiente familjare dhe ushqim tradicional, si dhe **bujtina “Art” në fshatin Vlosh**, e cila karakterizohet nga ambientet me dekor rustik dhe lidhja me natyrën përreth. Të dyja këto struktura funksionojnë kryesisht jashtë rrjetit formal të turizmit, pa prezencë të organizuar në platformat promovionale ndërkombëtare, çka paraqet një mundësi të pashfrytëzuar për formalizimin dhe zhvillimin e sektorit të akomodimit në nivel vendor. Rritja e numrit të bujtinave të regjistruara dhe mbështetja për certifikimin dhe promovimin e tyre përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të kapaciteteve akomoduese të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të agroturizmit dhe turizmit rural në Roskovec.

kulturore dhe eventeve sezonale. Kjo mungesë e informacionit të centralizuar kufizon orientimin e vizitorëve dhe pamundëson shfrytëzimin e plotë të ofertës turistike të zonës.

Pavarësisht këtyre mungesave, Bashkia Roskovec ka ndërmarrë disa iniciativa fillestare që synojnë të krijojnë bazën për zhvillimin e turizmit aktiv dhe natyror. Aktualisht, janë në ndërtim disa shtigje lokale për ecje dhe eksplorim në zonat me atraksione natyrore, si në Pyllin e Luarit, zonën e Kënetës së Zezë dhe përgjatë brigjeve të Lumit Seman, ndërsa rreth Liqenit të Kurjanit po zhvillohet një itinerar i posaçëm për ecje, vëzhgim të natyrës dhe piknik familjar. Paralelisht, është në proces krijimi edhe i një rruge biçikletash që do të lidhë disa nga atraksionet natyrore të zonës, duke nxitur zhvillimin e turizmit aktiv dhe përdorimin e mjeteve të qëndrueshme të lëvizjes.

Në territorin e bashkisë nuk funksionojnë aktualisht operatorë turistikë të regjistruar lokalë që ofrojnë ture të strukturuar, si vizita agroturistike, ecje të organizuara në natyrë apo paketa të integruara kulturore. Aktivitetet turistike aktualisht zhvillohen në mënyrë të rastësishme dhe kryesisht përmes njohjeve personale ose përfshirjes së agjencive turistike nga qytetet përreth. Këto agjenci, që operojnë kryesisht nga Fieri, Lushnja, Berati dhe Tirana, organizojnë ture fundjave që përfshijnë ndalesa në bujtina rurale, degustime të produkteve lokale dhe vizita në atraksionet natyrore e kulturore të zonës. Megjithatë, këto iniciative janë të fragmentuara, nuk kanë ende koordinim të drejtpërdrejtë me strukturat vendore dhe nuk përfshijnë në mënyrë të plotë komunitetin lokal në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm turistik.

Krijimi i një oferte turistike të strukturuar dhe të menaxhuar në nivel vendor përfaqëson një potencial të hapur që kërkon mbështetje institucionale për identifikimin, trajnimin dhe promovimin e operatorëve lokalë të turizmit. Përmirësimi i shërbimeve mbështetëse dhe ndërtimi i infrastrukturës së butë turistike janë hapa të domosdoshëm për ta pozicionuar Roskovecin si një destinacion të ri rural dhe natyror, të përshtatshëm për zhvillimin e turizmit fundjavor, edukativ dhe ekologjik.

3.4 Oferta Turistike Aktuale

Oferta turistike në Bashkinë Roskovec ndodhet aktualisht në fazat e para të zhvillimit, me mungesë të strukturave të konsoliduara dhe iniciativave të mirëkoordinuara. Territori disponon një fond të pasur asetesh natyrore, kulturore dhe traditash bujqësore, të cilat megjithatë shfrytëzohen ende në mënyrë të fragmentuar dhe shpesh informale, pa mbështetje të organizuar për promovim, rrjetëzim dhe integrim në tregun turistik kombëtar e ndërkombëtar.

Iniciativat ekzistuese përfshijnë kryesisht funksionimin e disa bujtinave familjare që ofrojnë përvoja autentike të mikpritjes rurale, organizimin herë pas here të aktiviteteve kulturore dhe lokale gjatë festave tradicionale, si dhe disa evente promovuese të prodhimeve bujqësore, të cilat tentojnë të krijojnë ura ndërmjet prodhuesve vendorë dhe konsumatorëve urbanë.

Pavarësisht sfidave ekzistuese, Bashkia Roskovec paraqet potencial të qartë zhvillimi në tre linja kryesore turistike: agroturizëm, ekoturizëm dhe turizëm kulturor, të cilat së bashku mund të ndërtojnë një produkt të integruar të turizmit të qëndrueshëm.

shkak të mungesës së qendrave interpretative, pikave të organizuara të pushimit, infrastrukturës bazë shoqëruese dhe mungesës së guidave të trajnuar mjedisorë.

Investimet në këto elementë të infrastrukturës së butë dhe ndërlidhja me ofertën kulturore dhe agroturistike përbëjnë hapa kyç drejt ndërtimit të një produkti të integruar ekoturistik për territorin e Bashkisë Roskovec.

3.4.3 Turizmi Kulturor

Trashëgimia kulturore e Bashkisë Roskovec përbën një aset me vlera të larta për zhvillimin e turizmit kulturor dhe edukativ. Kjo trashëgimi përfshin:

Pazarin e Vjetër të Roskovecit (i njohur edhe si Pazari i Frashërit), një qendër historike me vlera arkitektonike e sociale, e cila përbën potencial për rikualifikim si hapësirë multifunkionale për artizanatin, gastronominë dhe aktivitetet kulturore. Kishat e Shën Nikollës dhe Shën Gjergjit, që ruajnë dëshmi të trashëgimisë shpirtërore dhe arkitekturës tradicionale dhe mund të përfshihen në itinerare shpirtërore e kulturore. Muzeun Historik Vendor, i cili përmes pavioneve tematike pasqyron jetën etnografike, arsimore dhe kulturore të komunitetit dhe ka potencial edukativ për vizitorët dhe gjeneratat e reja. Kishën bizantine të Shën Kollit në Kurjan, monument unik i shekullit XIII me afreske të piktorëve Nikolla, biri i Onufrit, dhe Johan, që përfaqëson një nga asetet më të çmuara të trashëgimisë bizantine në Shqipërinë e Mesme.

Aktualisht, mungojnë paketat e organizuara kulturore, guidat e trajnuara, sinjalistika interpretuese dhe programet edukative për vizitorët, ndërkohë që hapësira për zhvillim të mëtejshëm kulturor mbetet e konsiderueshme. Potenciali për ndërtimin e itinerareve historike, bashkëpunimet me shkollat për edukim në terren, organizimi i eventeve komunitare që promovojnë historinë e zonës, dhe shfrytëzimi i platformave digjitale për promovim janë elementë kyç që mund të strukturojnë ofertën kulturore të zonës.

3.4.4 Eventet Lokale dhe Festivalet

Në funksion të promovimit të identitetit lokal dhe nxitjes së jetës komunitare, Bashkia Roskovec ka filluar organizimin e eventeve kulturore dhe bujqësore me potencial turistik. Ndër eventet më të konsoliduara spikat **Festa e Ullirit**, e cila zhvillohet çdo vit dhe synon të promovojë ullirin si produkt simbol të zonës, përmes panairove të produkteve vendore, aktiviteteve edukative dhe performancave artistike. Po ashtu, **Festa e Serave**, e organizuar në fund të muajit maj, ka si qëllim promovimin e prodhimeve të serave dhe sensibilizimin mbi rëndësinë e sektorit bujqësor për ekonominë lokale.

Pavarësisht se kalendari festiv është ende në formësim, ekziston interes i lartë nga komuniteti për zgjerimin e tij, duke përfshirë tregime, muzikë, kulinari tradicionale dhe ekspozita artizanale, veçanërisht me pjesëmarrjen aktive të grave dhe të rinjve. Ndërtimi i një kalendari të strukturuar eventesh, që mbështet nismat e komunitetit, mund të krijojë një model të qëndrueshëm turizmi të bazuar në ngjarje kulturore, duke i dhënë Roskovecit një dimension të ri atraktiviteti gjatë gjithë vitit.

3.5.1 Forcat (Strengths)

Pozita gjeografike strategjike e Bashkisë Roskovec ofron një avantazh të veçantë për zhvillimin e turizmit. Ajo ndodhet pranë akseve kombëtare Tiranë–Fier–Vlorë dhe Fier–Berat, duke siguruar lidhje të shpejta me qendrat kryesore urbane dhe turistike të vendit, çka lehtëson sidomos vizitat ditore dhe turizmin fundjavor, veçanërisht për turistët vendas dhe ata nga rajonet përreth.

Pasuritë natyrore dhe kulturore të larmishme të territorit përbëjnë një fond të vlefshëm për ndërtimin e produkteve të integruara të turizmit të qëndrueshëm dhe tematik. Kombinimi i burimeve natyrore si Këneta e Zezë, Liqeni i Kurjanit, Pylli i Luarit dhe lumi Seman, me trashëgiminë kulturore të përfaqësuar nga Pazari i Frashërit, kishat historike, zona të tjera historike të zonës dhe Muzeu Historik Vendor, krijon një portofol të pasur për zhvillimin e linjave të ndryshme të turizmit: kulturor, natyror, edukativ dhe rural.

Tradita bujqësore e konsoliduar është një tjetër aset thelbësor. Si pjesë e fushës së Myzeqesë, Roskoveci është pozicionuar ndër zonat më prodhuese të Shqipërisë, me produkte bujqësore cilësore si ulliri, perimet sezonale dhe produktet e serave. Ky potencial ekonomik përbën bazë të qëndrueshme për zhvillimin e agroturizmit, duke mundësuar lidhjen direkte të prodhimit lokal me përvojën turistike.

Një tjetër element i spikatur është ruajtja e autenticitetit dhe identitetit lokal. Mungesa e ndërhyrjeve masive komerciale apo industriale në sektorin e turizmit ka bërë të mundur ruajtjen e një ndjenje autenticiteti dhe origjinaliteti, gjithnjë e më e kërkuar nga vizitorët që kërkojnë përvoja të vërteta, të lidhura me kulturën dhe mënyrën tradicionale të jetesës.

Për më tepër, gjatë viteve të fundit është evidentuar edhe një mbështetje institucionale në rritje. Bashkia ka ndërmarrë hapa konkretë drejt zhvillimit të sektorit përmes hartimit të kësaj strategjie, organizimit të eventeve vjetore, ndërtimit të shtigjeve turistike dhe përfshirjes së komunitetit në proceset vendimmarrëse. Kjo dëshmon për vizionin afatgjatë të institucionit vendor në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

3.5.2 Dobësitë (Weaknesses)

Pavarësisht potencialeve të konsiderueshme, sektori turistik në Bashkinë Roskovec përballet aktualisht me një sërë kufizimesh strukturore dhe funksionale. Infrastruktura turistike është ende e pakonsoliduar. Mungojnë struktura të mirëfillta akomoduese të certifikuara si hotele apo bujtina të regjistruara, si dhe elementët e domosdoshëm të infrastrukturës shoqëruese si sinjalistika turistike e standardizuar, qendra informacioni, stacione ndihmëse dhe sisteme funksionale të transportit publik të orientuar drejt vizitorëve. Këto mungesa ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e përvojës së turistëve dhe në kufizimin e qëndrimeve afatgjata.

Promovimi i destinacionit mbetet gjithashtu i kufizuar. Prania e Roskovecit në platformat ndërkombëtare të promovimit turistik, rrjetet sociale, faqet turistike ndërkombëtare apo materialet e përkthyer në gjuhë të huaja është ende modeste. Mungesa e hartave të azhurnuara digjitale dhe fizike e vështirëson orientimin dhe planifikimin e vizitave për vizitorët potencialë.

Gjithashtu, **interesi në rritje i komunitetit lokal dhe bizneseve për t'u përfshirë në turizëm** përbën një mundësi të rëndësishme për krijimin e një ekosistemi turistik të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm. Përvoja pozitive e bujtinave ekzistuese, pjesëmarrja në evente lokale si “Festa e Ullirit” apo “Festa e Serave” dhe gatishmëria e familjeve rurale për të ofruar mikpritje dhe produkte lokale krijojnë një bazë solide për zhvillimin gradual të sektorit me përfshirje të drejtpërdrejtë të komunitetit.

3.5.4 Kërcënimet (Threats)

Pavarësisht potencialeve dhe mundësive të identifikuar, zhvillimi turistik në Bashkinë Roskovec përballët gjithashtu me disa kërcënime serioze që mund të kufizojnë ose të ngadalësojnë procesin e konsolidimit të sektorit.

Së pari, ekziston rreziku i **mungesës së investimeve publike dhe private** në sektorin e turizmit. Nëse nuk adresohen në kohë nevojat për infrastrukturë, promovim dhe ngritje kapacitesh, ekziston mundësia që Roskoveci të mbetet në periferinë e zhvillimeve turistike të rajonit, duke mos përfituar nga dinamika pozitive e zhvillimit rajonal dhe duke humbur iniciativat aktuale ekzistuese.

Konkurrenca nga destinacionet e konsoliduara si Berati, Gjirokastra apo Fieri (me Apolloninë) paraqet një sfidë serioze për destinacionet më të vogla dhe më pak të njohura. Këto destinacione tashmë gëzojnë njohje ndërkombëtare, kanë trashëgimi të konsoliduar, infrastrukturë turistike të zhvilluar dhe promovim aktiv. Pa paketa diferencuese dhe kanale efektive promovimi, Roskoveci mund ta ketë të vështirë të konkurrojë për flukset turistike.

Një kërcënim tjetër lidhet me **rrezikun e degradimit të burimeve natyrore dhe kulturore**. Zona të ndjeshme si Këneta e Zezë, Liqeni i Kurjanit dhe Pylli i Luarit janë të ekspozuara ndaj ndotjes, ndërhyrjeve informale ndërtimore dhe mungesës së kontrollit mjedisor. Pa sisteme të qëndrueshme të menaxhimit dhe ndërgjegjësim aktiv mjedisor, këto pasuri natyrore mund të dëmtohen, duke cenuar vetë bazën mbi të cilën mund të ndërtohet turizmi i qëndrueshëm.

Në planin kulturor e social, ekziston rreziku për **humbjen e autenticitetit kulturor** për shkak të emigrimit të rinjve, shpopullimit të zonave rurale dhe ndërprerjes së transmetimit të traditave ndër breza. Traditat kulinare, mikpritja dhe mënyrat tradicionale të jetesës përbëjnë vetë substancën e ofertës turistike kulturore dhe rurale; zbehja e tyre do të reduktonte ndjeshëm vlerën dhe atraktivitetin e destinacionit.

Së fundi, **ndryshimet klimatike** përbëjnë një kërcënim afatgjatë, që mund të ndikojë si në ekosistemet natyrore ashtu edhe në sektorët mbështetës si bujqësia. Ndryshimet në ciklet e prodhimit bujqësor dhe ndikimet klimatike mbi biodiversitetin mund të reduktojnë ofertën e produkteve lokale cilësore dhe të ndikojnë drejtpërdrejt në përvojën e vizitorëve që frekuentojnë zonën për natyrën dhe jetën rurale. Pa strategji adaptuese dhe masa mbrojtëse, këto sfida mund të prekin themelet e zhvillimit të qëndrueshëm turistik të Roskovecit.

5 PRIORITETET STRATEGJIKE

Bazuar në analizën e situatës aktuale, potencialet e identifikuar dhe në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2024–2030, kjo strategji përcakton pesë prioritetet strategjike për periudhën 2025–2030. Këto prioritetet përcaktojnë fushat kryesore të ndërhyrjes së koordinuar midis Bashkisë Roskovec, komunitetit lokal dhe partnerëve zhvillimorë, me synimin për të ndërtuar një destinacion turistik të qëndrueshëm dhe konkurrues në nivel rajonal. Çdo prioritet do të konkretizohet përmes masave të strukturuar ndërhyrjeje dhe do të mbështetet me instrumente financimi, mekanizma monitorimi dhe angazhim të gjerë social.

5.1 Zhvillimi i Produkteve Turistike Lokale dhe Autentike

Bashkia Roskovec zotëron një pasuri të shumëllojshme natyrore, kulturore dhe bujqësore, e cila mund të shndërrohet në një portofol të qëndrueshëm produktesh dhe përvojash turistike. Hartimi i produkteve të strukturuar dhe pozicionimi i tyre në treg bazuar në karakteristikat unike të territorit, përbën themelin për ndërtimin e ofertës turistike lokale.

Qëllimi:

Të zhvillohet një portofol i integruar produktesh turistike tematike dhe gjithëvjetoje, që reflektojnë karakterin lokal, trashëgiminë dhe potencialin natyror të zonës, duke krijuar përvoja autentike për vizitorët dhe përfitime ekonomike për komunitetin.

Masat prioritare:

1. Hartimi i itinerareve tematike që lidhin asetet natyrore, kulturore dhe bujqësore në paketa të diversifikuara:
 - Agroturizëm (vizita në ferma, aktivitete bujqësore, prodhime kulinare tradicionale);
 - Turizëm natyror (shtigjet e Pyllit të Luarit, Liqeni i Kurjanit, Këneta e Zezë, Rezervuari i Ngjeqarit);
 - Turizëm kulturor (kisha bizantine, Pazari i Frashërit, Fantana e Naftës, Muzeu Historik Vendor).
2. Mbështetja e mikrobizneseve rurale dhe familjeve lokale për zhvillimin e bujtinave, punishteve artizanale dhe produkteve kulinarike autentike (degustime, kurse gatimi, prodhime artizanale).
3. Krijimi i “rrugëve tematike” të pozicionuara në treg:
 - **Rruga e Ullirit:** vizita në plantacione ulliri, përpunimi i vajit të ullirit, tregje lokale, tregime dhe legjenda të lidhura.
 - **Rruga e Traditës:** itinerare të trashëgimisë kulturore dhe historike, punime artizanale, tregje, muze dhe evente lokale.
4. Ndërtimi i paketave bashkëpunuese mes operatorëve lokalë (bujtina, guida, fermerë, artizanë), për të ndërtuar oferta të integruara që përfshijnë eksperiencë, akomodim dhe promovim.

4. Mbështetja teknike dhe ligjore për formalizimin e strukturave akomoduese rurale, përfshirë:
 - Ndihmë në proceset e legalizimit;
 - Trajnime mbi menaxhimin e mikpritjes dhe promovimin në tregjet online.

Indikatorë të pritshëm monitorimi:

- Të rehabilitohen të paktën 2 segmente rrugore që lidhin atraksione kyçe;
- Të vendosen të paktën 10 tabela sinjalistike turistike në atraksione dhe shtigje të përzgjedhura;
- Të ngrihet dhe funksionalizohet Qendra e Informacionit Turistik me staf dhe materiale për vizitorët;
- Të mbështeten të paktën 3 bujtina rurale për të hyrë në tregun formal të mikpritjes dhe promovimit digjital.
- Të rikonstruktohen të paktën dy rrugë shëtitëse në atraksione turistike

5.3 Rritja e Kapaciteteve Njerëzore dhe Organizative

Zhvillimi afatgjatë i sektorit të turizmit në Roskovec kërkon ndërtimin e burimeve të qëndrueshme njerëzore dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale në nivel vendor. Formimi profesional i aktorëve lokalë dhe forcimi i kapaciteteve menaxheriale të bashkisë janë kushte të domosdoshme për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore dhe për të përmbushur standardet e një destinacioni konkurrues.

Qëllimi:

Të zhvillohen kapacitetet njerëzore dhe organizative të nevojshme për menaxhimin efektiv të destinacionit, përmirësimin e shërbimeve dhe ndërtimin e një kulture të qëndrueshme mikpritjeje në nivel komuniteti.

Masat prioritare:

1. Organizimi i programeve të trajnimit për:
 - Guida lokale dhe interpretuese të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
 - Sipërmarrës të vegjël dhe mesatarë në mikpritje (bujtina, agroturizëm, restorante);
 - Administratën vendore për menaxhimin e turizmit të qëndrueshëm dhe planifikimin e destinacionit.
2. Hartimi dhe shpërndarja e manualeve praktike mbi mikpritjen dhe standardet minimale të shërbimeve, të përshtatura për kontekstin e Roskovecit dhe të aksesueshme për komunitetin.

4. Përfshirja aktive në platforma kombëtare dhe ndërkombëtare të promovimit turistik si IntoAlbania, VisitAlbania, DiscoverFier, si dhe krijimi i partneriteteve me agjenci turistike dhe media të specializuara.

Indikatorë të pritshëm monitorimi

- Të krijohen dhe funksionalizohen të paktën 2 kanale digjitale kryesore (faqe ëeb dhe rrjet social);
- Të realizohen të paktën 2 fushata vizuale promovuese sezonale për atraksionet dhe eventet turistike;
- Të përfshihet Roskoveci në të paktën 3 platforma promovimi kombëtare ose ndërkombëtare;
- Të prodhohen të paktën 5 materiale multimediale (1 video, 2 broshura, 2 albume fotografike profesionale).

5.5 Përfshirja e Komunitetit dhe Partneritetet Lokale

Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në Roskovec kërkon angazhimin e drejtpërdrejtë të komunitetit si aktor kryesor në ndërtimin dhe menaxhimin e ofertës turistike. Fermerët, gratë, të rinjtë dhe sipërmarrësit lokalë përbëjnë bazën e ekonomisë turistike lokale dhe garantuesit e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Qëllimi:

Të forcohet pjesëmarrja aktive e komunitetit në proceset e planifikimit, ofrimit dhe menaxhimit të turizmit përmes partneriteteve lokale dhe mbështetjes së ndërmarrjeve me bazë komunitare.

Masat prioritare:

1. Organizimi i forumeve komunitare periodike (vjetore ose sezonale), për të mbledhur ide, diskutuar nevojat dhe për të ndërtuar konsensus mbi zhvillimin e turizmit në bashki.
2. Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve lokalë: fermerë, artizanë, gra, të rinj, shkolla, OJF dhe institucione vendore, për ndarjen e burimeve dhe bashkëkrijimin e paketave të përbashkëta turistike.
3. Mbështetje financiare, teknike dhe mentorim për gratë, të rinjtë dhe fermerët që dëshirojnë të krijojnë mikrobiznese turistike (bujtina, guida, artizanat, aktivitete agro-kulinare), përmes lidhjes me programet kombëtare dhe ndërkombëtare të financimit.

Indikatorë të pritshëm monitorimi

- Të organizohen të paktën 1 forum komunitar çdo vit, me përfaqësim të grupeve të ndryshme sociale dhe gjinore;
- Të krijohen të paktën 2 rrjete funksionale bashkëpunimi në sektorin e turizmit (mikpritës ruralë, rrjet artizanësh lokalë);

6 PLANI I VEPRIMIT (2025-2028)

Prioriteti 1: Zhvillimi i Produkteve Turistike Lokale dhe Autentike

Masa	Aktivitetet Kryesore	Përparësia	Afati Kohor	Përgjegjësia Kryesore	Partnerë Mbështetës	Burimet Nevojshme	Indikatorët e Suksessit	Kosto e Përlogaritur (€)
1. Hartimi i itinerareve për agroturizëm, turizëm natyror, historik dhe kulturor, Liqeni i Kurjanit, Rezervuari Ngjeqar, Zona Naftëmbajtëse, Marinëz.	Identifikim destinacionesh, krijim itinerareve, materiale promovuese, vizita pilot	Shumë lartë	2025–2026	Bashkia Roskovec	MTM, MBZHR projekte të BE ose donatorë si GIZ, UNDP etj OJF	Ekspertizë turistike, logjistikë, hartografi, dizajn grafik	3 produkte turistike të strukturuar	20,000–25,000 €
2. Mbështetje për mikrobiznese që ofrojnë përvoja bujqësore, kulinare ose artizanale	Thirrje për ide, trajnimë, mini-grante, promovim në paketat ekzistuese	Shumë lartë	2026–2028	Bashkia Roskovec	AZHBR, MBZHR donatorë	Fonde për mikrobiznese, asistencë teknike	5 operatorë lokalë të përfshirë në paketat turistike	50,000–100,000 €

Masa	Aktivitetet Kryesore	Përparësia	Afati Kohor	Përgjegjësia Kryesore	Partnerë Mbështetës	Burimet Nevojshme	Indikatorët e Suksessit	Kosto e Përlogaritur (€)
turistike								rrugët dytësore)
2. Vendosi e sinjalistikës dhe hartave orientuese	Hartim dizajni, përzgjedhje vendndodhjesh, prodhim dhe instalim tabelash	E lartë	2026	Bashkia Roskovec	MTM, projekte GIZ/BE, OJF, donatorë	Dizajn, printer signage, staf teknik	Të vendosen të paktën 10 tabela sinjalistike	20,000–30,000 €
3. Ngritja e një pike informacioni i turistit dhe mbështetje për bujtina rurale	Identifikim lokacioni, ngritje strukture info, trajnime staf, mbështetje me mikro-investime për bujtinat	Mesatare	2027–2028	Bashkia Roskovec	MTM, BE, UNDP, projekte zhvillimi rural	Infrastruktura fizike, staf, pajisje, asistencë teknike	1 pikë informacioni funksionale; 2-5 bujtina të mbështetura me asistencë dhe mikro-investime.	100,000 – 170,000 € (duke llogaritur investimin në një zyrë info turistike + asistencë për bujtinat + pajisje)

Prioriteti 3: Rritja e Kapaciteteve Njerëzore dhe Organizative

Masa	Aktivitetet Kryesore	Përparësia	Afati Kohor	Përgjegjësia Kryesore	Partnerë Mbështetës	Burimet Nevojshme	Indikatorët e Suksessit	Kosto e Përlogaritur (€)
1. Trajnime për guida, operatorë	Organizim sesione trajnimi për	Shumë e lartë	2025–2026	Bashkia Roskovec	Projekte donatorësh	Trajnerë, materiale trajnimi,	Të trajnohen të paktën 15 persona lokalë,	10,000–15,000 €

Masa	Aktivitetet Kryesore	Përparësia	Afati Kohor	Përgjegjësia Kryesore	Partnerë Mbështetës	Burimet Nevojshme	Indikatorët e Suksesit	Kosto Përlogaritur (€)
								<i>aplikimeve për certifikim.)</i>

Prioriteti 4: Promovimi Digjital dhe Ndërtimi i Imazhit të Destinacionit

Masa	Aktivitetet Kryesore	Përparësia	Afati Kohor	Përgjegjësia Kryesore	Partnerë Mbështetës	Burimet Nevojshme	Indikatorët e Suksesit	Kosto Përlogaritur (€)
1. Krijimi dhe mirëmbajtja e faqeve në rrjetet sociale dhe një faqe ëeb informuese	Hapja e kanaleve në FB/IG, dizajn dhe përmbajtje për faqe ëeb, përditësime të rregullta	Shumë e lartë	2025–2026	Bashkia Roskovec	Agjenci marketingu	Staf komunikimi, dizajn, hosting	2 kanale digjitale funksionale deri në 2026	5,000–7,000 €/vit (kosto vjetore operacionale)
2. Prodhimi i materialeve promovuese (video, foto, broshura)	Prodhim video të shkurtra për atraksione, broshura për shpërndarje në ngjarje dhe rrjete sociale	E lartë	2026	Bashkia Roskovec	MTM, projekte promovimi kombëtar	Video/foto profesionistë, dizajn grafik	2 fushata promovimi vizual të realizuara	10,000–30,000 €
3. Përfshirja në platformat kombëtare	Krijim profile destinacioni në platformat	Mesatare	2025–2027	Bashkia Roskovec	AKT, MTM, Donatore	Koordinim institucional, bashkëpunime	Profil i përditësuar në të paktën	3,000 -5000 €/vit <i>shpenzime për: koordinim</i>

Masa	Aktivitetet Kryesore	Përparësia	Afati Kohor	Përgjegjësia Kryesore	Partnerë Mbështetës	Burimet e Nevojshme	Indikatorët e Suksesit	Kosto e Përlogaritur (€)
turistike	guida të reja							<i>marrëveshje bashkëpunimi, udhëzues funksionimi të rrjeti, Trajnime).</i>
3. Mbështetje për gratë dhe të rinjtë në ngritjen e mikrobizneseve turistike	Thirrje të posaçme për ide biznesi, trajnim bazë, lidhje me skema mbështetëse	Shumë e lartë	2025–2027	Bashkia Roskovec	AZHBR, MoE UN Women Projekte donator	Trajnime, mentorim, fonde fillestare	5 biznese të reja të ngritura nga gra/të rinj	50,000–100,000 €



8 ANEKSE

Burime të Përdorura

1. Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024–2030 – Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
<https://turizmi.gov.al/strategjia-kombetare-e-turizmit-2024-2030/>
2. Bashkia Roskovec – Evente dhe festivale lokale
3. AZHBR – Rural Tourism in Roskovec, Fier
<https://azhbr.gov.al/en/rural-tourism-in-roskovec-fier/>
4. AZHBR – Zhvillimi i turizmit rural në Roskovec
5. RoamingVerse – Roskovec Travel Guide
<https://roamingverse.com/albania/fier-county/roskovec>
6. Trip.com – Things to Do in Roskovec
<https://ëëë.trip.com/travel-guide/destination/roskovec-1878850/>
7. UNDP Albania – Profilet e Bashkive: Roskovec
<https://ëëë.al.undp.org/content/albania/sq/home/library/profilet-e-bashkive/roskovec.html>
8. RoamingVerse – Roskovec: atraksione dhe tregje
9. Trip.com – Things to Do in Roskovec
10. Traveloka – Udhëzues për Bashkinë Roskovec

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDESKRYETAR

Maksim Goga



MIRATOI
KRYETAR
Majlinda Bufi

